



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr 131, datë 18-12-2025.2025

MBI

MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.05.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 38 të Ligjit 22/2018 “Për Strehimin social” i ndryshuar, në pika 4 e VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM Nr. 301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, VKM Nr. 459 datë 03.07.2019 Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimit dhe bashkëpunimit ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKB mbi miratimin “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”, Udhëzimit Nr. 31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, paraqesim për miratim vlerën maksimale të subvencionimit të qirasë dhe vlerën mesatare të qirasë në tregun e lirë për programin “Subvencionimi i Qirasë” që zbatohet nga Bashkia Korçë dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

- 1.Të miratojë vlerën maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelin e qirasë mesatare në tregun e lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Korçë, sipas tabelës bashkangjitur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit, Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratur me 32 vota

Vota Pro 32

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 18-12-2025



KRYETARI
Ana VERUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË

Tabela.1

Niveli mesatar i qirasë në tregun e lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Korçë për vitin 2026.

Nr	Emërtimi, tip i apartamentit	Sip.neto/m ² VKM Nr.301,dt.15.04.2020	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar/lekë
1	Ap.Garsonierë	30-45max	muaj	1	8,350
2	Ap. 1+1	40-55max	muaj	1	13,610
3	Ap. 2+1	50-81max	muaj	1	15,600
4	Ap. 3+1	60-100max	muaj	1	20,000

KRYETAR
Ana VERUSHI

